



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARES TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E
PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK KONJUH

Neni 1

Me këtë Vendim **zëvendësohet** anëtaria e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.462/01-53367 i datës 15.09.2023, Arbnora Dedushi në numrin rendor 5, nga shoqëria civile e caktuar sipas Vendimit Nr.15-020/04-61653 për zëvendësimin e anëtares së Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh i datës 30.10.2023, sipas kërkesës së saj për dorëheqje dhe në vend të saj caktohet Adriatik Llugini poashtu nga shoqëria civile e përzgjedhur përmes Ftesës publike 1Nr.020/02-9267 të datës 27.02.2025 .

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të komisionit është i përcaktuar me dispozitat e Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr-020/04-53379 të datës

15.09.2023 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Zëvendësimi i anëtares së lartëcekur bëhet duke u bazuar në kërkesën së saj për dorëheqje për arsye personale dhe në vend të saj propozohet Adriatik Llugini poashtu nga shoqëria civile i përzgjedhur përmes ftesës publike 1Nr.020/02-9267 e datës 27.02.2025.

Nga të cekurat kërkojmë nga Kuvendi Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/04-11746
Lipjan, 14.03 2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

